UDHËZIM
Nr. 12, datë 28.4.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, fjalia e parë e germës "ii", të paragrafit 2.8.6 të udhëzimit, ndryshohet me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

"ii. Në llogaritjen e taksës për ambalazhin plastik, nga pesha bruto, do të zbritet pesha e paletave të drurit, paletave të kartonit dhe paletave metalike.".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj